

**AKT THEMELIMI I SHOQËRISË ME PËRGJËGJËSI TË KUFIZUAR**  
“shpk

Në Tiranë, sot më datë 01.12.2021, i poshtëshënuari:

- 1- Elton Kerkuti, i datëlindjes 04.06.1990, lindur në Maqellare , Diber dhe banues në Diber, identifikuar me dokument identifikimi: Letërnjoftim ID, me numër personal J00604006D,
- 2- Edmir Piku, datëlindjes 16.03.1987, në Maqellare,Diber dhe banues në Tiranë, identifikuar me dokument identifikimi: Letërnjoftim ID, me numër personal I70316135K

me cilësinë e “ortakëve themelues” deklarojmë se me vullnet të lirë të plotë, mbeshtetur në ligjin Nr.9901 datë 14.04.2008, “ Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar, ligjin Nr. 9723, datë 3.5.2007 “ Për Regjistrimin e Biznesit“, i ndryshuar, krijojmë shoqërinë tregtare me përgjegjësi të kufizuar, “**E&E Electronics Shop**“ shpk,

*Neni 1*  
*Emri, Forma*

Shoqëria do të ketë emrin ‘**E&E Electronics Shop**’, dhe formë ligjore: “Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar” (më poshtë e quajtur “Shoqëria”).

*Neni 2*  
*Personaliteti juridik*

Shoqëria fiton personalitetin juridik, pasi të jetë regjistruar në QKB, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

*Neni 3*  
*Selia*

Shoqëria e ka selinë në adresë: Rruga Drenova , Nderresa nr.7 , kati 1

*Neni 4*  
*Objekti i veprimtarisë*

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë do të jetë:

Sherbime elektrike dhe kamera sigurie, te llojeve te ndryshme, e çdo sherbim tjeter te ngjashem dhe qe ka lidhje me kete fushe. Tregtim me shumice e pakice, import-eksport i paisjeve produkteve teknike, elektrike dhe elektronike,televizorë, lap-top, kompjuter, kamerava, paisjeve e pjeseve te tyre e çdo tjeter qe ka lidhje me to. Shoqeria ne te ardhmen mund te zgjeroje fushen e aktivitetit te saj ne perputhje me performancen ekonomike te shoqerise dhe legjislacionin ne fuqi. Shoqeria mund te kete marredhenie bashkepunimi me shoqeri te tjera qe operojne ne fusha te ndryshme te se drejtes civile e tregtare shqiptare, te kete te drejten e shit-blerjes se kuotave te ortakeve apo ortakut

te vetem te nje shoqerie tjetër, te ofroje garanci te çdo lloji qe parashikon ligji per aktivitetin e ligjshem te çdo subjekti fizik, juridik privat. Te aplikojë e marrë pjesë ne tendera, punime specifike me natyrë sipas llojit te aktivitetit te shoqërisë apo te ngjashme me to etj

Neni 5  
Kohëzgjatja

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj pa afat.

Neni 6  
Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i nënshkruar dhe i shlyer i shoqërisë është 100 lekë, i ndarë në dy kuota, i cili zotërohet si më poshtë:

Elton Kerkuti, zotëron 1 kuotë me vlerë 50 lekë, e cila përbën 50 % të kapitalit të shoqërisë

Edmir Piku, zotëron 1 kuotë me vlerë 50 lekë, e cila përbën 50% të kapitalit të shoqërisë

Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta)

Ortakët nuk përgjigjen për detyrimet e shoqërisë tregtare dhe mbulojnë personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara.

Neni 7  
Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyrë tjetër të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit te saj ne Qendren Kombetare të Biznesit, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

Neni 8  
Organi Vendimmarrës

Asambleja e Ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë, për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat “c” dhe “ç” të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

Neni 9  
Administrimi

Administratorë i shoqërisë është:

- Edmir Piku, datëlindjes 16.03.1987, në Maqellare, Diber dhe banues në Tiranë, identifikuar me dokument identifikimi: Letërnjoftim ID, me numër personal I70316135K emëruar në këtë detyrë për një afat 5 vjeçar me të drejtë ripërtritje.

Neni 10  
Baza Ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë akt themelimi dhe dispozitat e legjislationit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet në këtë akt themelimi, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

Neni 11  
Dispozita perfundimtare

Ky akt themelimi u redaktua ne 4 kopje, në gjuhën shqipe, me përmbajtje dhe vlera te njëjta juridike.

Akti i mësipërm pasi miratohet në parim dhe nen per nen nga Ortakët themelues të shoqërisë tregtare "E&E Electronics Shop " shpk , nënshkruhet në të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmen orgjinale.

**ORTAKËT THEMELUES**

Edvin Keku



Edmir Piku

